

STATUTI

I SHOQERISE “FANTAZIA BLU” SH.P.K.

Ne mbeshetje te Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, si dhe te gjithë Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

ZNJ. SILVANA ZAKJA, e bija e SALIUT, lindur me 03/02/1971, lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane ne adresen: Arkitekt Kasemi Pallati 60 , Shkalla 2, Apartamenti 18, shtetase shqiptare, me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem themelues, sot me date 01/02/2018, hartoi kete statut te Shoqerise tregtare “FANTAZIA BLU” SH.P.K.

KAPITULLI I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Themelimi, Forma, Emertimi

- 1.1 Sot me date 01/02/2018 krijohet shoqeria “FANTAZIA BLU” SH.P.K. Ky emertim eshte i vetmi i shoqerise dhe perdoret ne te gjithë rregjistrimet, transaksionet, marveshjet dhe komunikimet e saj me te tretet apo shtetin dhe eshte i vlefshem si jashte dhe brenda vendit.
- 1.2 Shoqeria “FANTAZIA BLU” SH.P.K.. eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, veprimtaria e te cilit do te rregullohet me ane te ketij Statuti dhe Aktit te Themelimit.
- 1.3 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj identifikuese, ne formen dhe me ekstremitetet e caktuara nga ortaku i vetem.
- 1.4 Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 1.5 Akti i themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuar ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2

Themeluesi

Shoqeria themelohet nga shtetësja shqiptare **Silvana ZAKJA** e cila eshte ortake e vetme e shoqerise.

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise

3.1. Objekti i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin tregtar aktual shqiptar do te jete:

- Floktore, Parukeri.
- Kurse te formimit profesional per parukiere dhe estetiste.



3.2 Pershkrimi i objektit te shoqerise ka natyre indikuese dhe jo kufizuese. Per realizimin e qellimit te saj shoqeria mund te bashkepunoje me çdo person fizik apo juridik ne çdo menyre qe e gjykon te dobishme.

3.3 Shoqeria ne çdo kohe mund te ripercaktoje objektin e saj, ta shtojte apo pakesojte ate, me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4

Selia e shoqerise dhe deget

4.1 Selia e shoqerise do te jete ne Tirane ne adresen: **Rruga Lidhja e Prizrenit nr. 7, Tirane.**

4.2 Transferimi i selise se shoqerise ne nje vend tjetër behet me vendim te Ortakut te Vetem.

4.3 Shoqeria ke te drejte te operoje me zyra, filiale, dege apo agjenci ne te gjithë territorin e Shqiperise apo edhe jashte shtetit.

4.4 Zyrat, filiale, deget apo agjencite krijohen me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise, i cili organizon punen dhe emerone organet drejtuese dhe perfaqesuesit e tyre ligjor.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise

5.1 Kohezgjatja e shoqerise "FANTAZIA BLU" SH.P.K. eshte e pakufizuar.

5.2 Ky afat mund te ndryshohet ne çdo kohe me vendim te ortakut te vetem.

5.3 Shoqeria mund te priset ne cdo moment me vendim te ortakut te vetem.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke dhe perbehet nga 1 kuote me vlere nominative 100.000 leke.

6.2.Ortaku themelues Sivana Zakja eshte zoterues i 1 kuote me vlere te pergjithshme 100.000 lek dhe qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 7

Ndryshimi i kapitalit themeltar

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenskrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre , nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, ecila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 8

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike i perkasin ortakut te vetem, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.



Neni 9

Shoqeria "FANTAZIA BLU" SH.P.K. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje e te shfrytzoje te drejta te tjera materiale ose jomateriale duke perfshire edhe te drejten e shitjes se pasurise se vet te te tretet.

Neni 10

Shoqeria "FANTAZIA BLU" SH.P.K. sh.p.k vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejtat e detyrimet vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaku themelues i shoqerise mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem deri ne nivelin e kapitalit se investuar ne te.

Neni 11

Kuotat e kapitalit te shoqerise mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

KAPITULLI III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 12

Organi vendimmarres

12.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise per ceshtjet e meposhtme

- Ndryshimin e Aktit te Themelimit dhe Statutit te shoqerise;
- Miratimin e buxhetit vjetor te shoqerise, te raporteve te administrimit, te inventareve dhe bilancit e llogarive vjetore te saj;
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- Zgjedhjen e administratoreve dhe caktimin e detyrave e kompetencave te tyre, pervec atyre te percaktuara ne Statut;
- Aprovimin e garancive qe jep shoqeria;
- Miratimin e çmimeve dhe tarifave te mallrave apo sherbimeve qe ofron Shoqeria ne treg;
- Fillimin dhe nderprerjen e marredhenieve te punes me punemarresit e shoqerise;
- Caktimin dhe ndryshimin e shenjave dalluese te shoqerise si vula dhe logoja e saj;
- Mbikqyrjen e administratorit te shoqerise ne menyren se si ai kryen detyren e tij;
- Zhveshjen nga kompetencat te administratorit dhe kryerjen nga ana e tij te te gjitha veprimeve te administrimit te shoqerise ne emer dhe per llogari te saj;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;
- Çdo kompetence tjeter qe i jepet nga ligji tregtar.

Neni 13

Administrimi

13.1 Administrator i shoqerise emerohet per nje afat 5 (pese) vjecar:

ZNJ. SILVANA ZAKJA, e bija e Saliut , lindur me 03/02/1971, lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane ne adresen: Arkitekt Kasemi Pallati 60 , Shkalla 2, Apartamenti 18 .

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Administratori pervec detyrave qe i cakton ortakut i vetem i shoqerise ka edhe keto te drejta e detyra te tjera:

- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme, te mireadministroje pasurine e shoqerise;
- Te lidhe marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga ortakut i vetem;
- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise.
- Te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.
- Te krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe e kercenojne mbarevajtjen e shoqerise dhe ekzistencen e saj.
- Kryejne regjistrime dhe dergojne te dhena te detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per QKB-it.
- Te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, shkelje te statutit apo per faj te kryer gjate administrimit te shoqerise Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise sipas neneve 14,15,17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" , Administratori detyrohet:

- Te zbatoje rregulloren e brendshme te shoqerise;
- Te shperbleje demet qe i vijne shoqerise si pasoje e veprimeve apo mosveprimeve te tij;
- Te paguhet per punen e kryer ne baze te marreveshjes se bere midis tij dhe ortakut te vetem;
- Te marre te dhena e te beje propozime mbi gjithshka qe ai e quan te dobishme per shoqerine;
- Te arandaloje dhe te menjenoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale mbi ata te shoqerise
- Te kryeje çdo detyre tjeter qe i ngarkohet nga ortakut i vetem i shoqerise.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMIT

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht Viti i pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit dhe perfundon ne 31 Dhjetor te te njejt vit.

Neni 17

Inventari dhe llogarite vjetore

17.1 Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.

Ne mbyllje te vitit financiar, administratori harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per vitin financiar.

Neni 18

Eksperti kontabel i autorizuar

18.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga ortakut i vetem i shoqerise, kontrolli i bilaneve dhe librave kontabel te shoqerise mund t'i besohet nje eksperti kontabel te autorizuar.

18.2 Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi

Neni 19

Raportet Vjetore

19.1 Ne mbylljen e çdo viti financiar Administratori dhe eksperti kontabel (nese eshte emeruar) ben inventaret dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per ortakun e vetem.

19.2 Bilancit i bashkengjiten nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria dhe nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria

19.3 Raporti pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e rendesishme, etj.

19.4 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar (nese eshte emeruar) miratohen nga ortakut i vetem sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare"

Neni 20

Rezultatet e vitit financiar dhe caktimi i fitimeve

20.1 Rezultati i vitit financiar percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire te keto te fundit amortizimet dhe provizionet.

20.2 Shuma e fitimeve te mbetura pas heqjeve per krijimin e rezervave perfaqeson dividentin, i cili i shperndahet .

20.3 Duke perjashtuar rastin kur eshte vendosur zvogelimi i kapitalit, nga fitimet e vitit financiar nuk behet asnje heqje dhe asnje derdhje dividenti, ne qofte se kapitalet e veta jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumen minimale te kerkuar per rezerven e domosdoshme.

20.4 Ne qofte se ekziston nje humbje, kjo mbartet per t'u perfshire ne fitimet e vitit financiar te ardhshme deri ne shuarjen e saj.

Neni 21

Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme

21.1 Nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar pasi zbriten humbjet e vitit te meparshem, hiqet menjane nje shume e barabarte me 5 % (pese perqind) e fitimit e destinuar per formimin e fondit rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme".

21.2 Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 10 % te kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsye çfaredo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 10 % te kapitalit.

21.3 Ortaku i vetem mund te vendose edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyerjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht apo pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme

Neni 22

Fitimi qe shperndahet

22.1 Koha, menyra dhe shuma e fitimit qe shperndahen vendoset rast pas rasti nga Ortaku i vetem sipas raportit te administrimit ne perputhje me kete Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare te shoqerise.

KAPITULLI V

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 23

Likuidimi i shoqerise

23.1 Menjehere pas marrjes se vendimit per prishjen e shoqerise, ortaku i vetem cakton nje likuidator, kompetencat e tij dhe menyren e likuidimit te shoqerise, ne perputhje me dispozitat perkatese te ligjit tregtar.

23.2 Likuidatori i emeruar nga ortaku menjehere sapo merr detyren eshte i detyruar te publikoje bilancin e shoqerise duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vene ne dispozicion menjehere ortakut te vetem.

23.3 Me caktimin e likuidatorit pezullohen te gjitha kompetencat e Administratorit dhe ato i kalojne likuidatorit.

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 24

Dispozita te fundit

24.1 Per te gjitha çeshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozitat e ligjit Nr.9901 dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

24.2 Per efekt te interpretimit te ketij Statuti me ligj tregtar nenkuptohet ligji Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

24.3 Pavlefshmerite eventuale te dispozitave te vecanta te Statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine e tij.

Neni 25

Personaliteti juridik i shoqerise

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit

Neni 26

Gjykata kompetente

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarrveshjeve midis ortakeve dhe interpretimin e statutit te shoqerise eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 27

Hyrja ne fuqi

Ky Statut hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga ortaku i vetem.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

I SHOQERISE "FANTAZIA BLU" SH.P.K

ZNJ.SILVANA ZAKJA

Silvana Zakja
